



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.215/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Gyltene Sylejmani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Partija Kosovskih Srba (PKS), dega Laposaviq paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, dega Laposaviq, me seli në Mitrovicë, për shkak të dëmtimit të posterave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr. 215/2019 e datës 04.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Partia e Serbëve të Kosovës PKS, dega Laposaviq, kundër subjektit politik, Lista Serbe, dega Laposaviq, me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Lista Serbe, t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të dëmtimit të posterave të subjektit ankues nga komuna e Laposaviqit.

A r s y e t i m

Me datën 04.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Partia e Serbëve të Kosovës (PKS), i cili pretendon se subjektit të tyre i bëhet shkelje e të drejtave për vendosjen e posterave zgjedhor nga aktivistët e subjektit politik, Lista Serbe. Po ashtu pretendohet se bëhet shkatërimi i materialit zgjedhor të subjektit të tyre në më shumë se 140 lokacione, në komunën e Laposaviqit, si dhe shkatërimin e billbordeve të tyre. Lidhur me këtë rast pretenduesi i ankesës ka theksuar se subjekti i tyre ka lajmruar Shërbimin e Policisë së Kosovës dhe thekson se nëse janë të nevojshme dëshmitë për lajmrimin e Policisë, mund ti dërgojn ato vërtetime.

Ankesës ia kanë bashkangjitur disa fotografi të materialit të dëmtuar të subjektit tyre PKS.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjekti politik Partija Kosovski Srba (PKS), ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Lista Serbe, me pretendimin se pjesëtarët e kësaj partie kanë dëmtuar materialin zgjedhor të subjektit të tyre në shumë lokacione, madje si provë kanë bashkangjitur disa foto ku shihen posterët janë të dëmtuar. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e

njëjta i është dërguar subjektit Lista Serbe për të dhënë përgjigje, por nga i njëjti subjekt nuk ka dhënë përgjigje. Njëherit nga ankuesi jemi njoftuar se ka lajmruar rastin në polici por nuk ka prezentuar kurrfarë raporti policor për dëmtimin e posterave të tyre.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë konstatoi se nuk ka dyshim që posterat janë dëmtuar sepse kjo vërtetohet përmes fotove, mirëpo me asnjë provë nuk mund të vërtetohet se dëmtimin e posterave e kanë bërë aktivistët e subjektit politik Lista Serbe, pra me anë të ankesës mund të vërtetohet se subjekti Lista Serbe, është përgjegjës për shkelje të nenit 33 paragrafi 1 pika b e cila i referohet rasteve të largimit, dëmtimit të posterave të subjektit ankues.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 215/20179 më datën 05.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haxhi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së